

INSTALACIONI ARTISTIK

Krimet e komunizmit për një kohë shumë të gjatë, rreth 28 vite demokraci, kanë mbetur jashtë vëmendjes së publikut dhe larg çdo qasjeje reflektuese.

EDHE | MURET
KANE | VESHE

Çështja

Mosinteresimi shoqëror dhe ndonjëherë mospranimi i së vërtetës së hidhur të krimeve komuniste është shqetësim real në Shqipëri. Ky qëndrim apatik rrezikon të ketë ndikim te brezat e rinj. Lind nevoja e gjetjes së mjeteve më efikase për transmetimin te brezi i ri i historive të dhunës dhe terrorit të shtetit të diktaturës së proletariatit e mbijetesës së personave të dhunuar nga krimi komunist.

Roli i AIDSSH-së

AIDSSH ka ndërmarrë një fushatë të gjerë që të rrisë ndërgjegjësimin për krimet e komunizmit, të inkurajojë dialog me universitetet, akademikët, komunitetet vendore, të mbijetuarit dhe familjarët e krimeve të diktaturës komuniste, mediat dhe publikun e gjerë.



Arritje

- Në Ditën e Europës - 8 Maj 2018, në sheshet kryesore të gjashtë qyteteve: Tiranë, Shkodër, Berat, Korçë, Tepelenë, Gjirokastrë, përgjatë gjithë natës deri në agim, u projektua në të njëjtën kohë instalacioni “Edhe muret kanë veshë”.
- Instalacioni, i realizuar nga artistë të mirënjohur shqiptarë dhe ekspertë të komunikimit, është një krijim shumëdimensional i kujtesës kolektive për ata që u dënuan, humbën lirinë apo jetën në burgjet dhe kampet e diktaturës komuniste. Frazat apo thëniet që përshkruajnë tragjedinë njerëzore të shkaktuar nga krimet e komunizmit janë shkëputur nga dorëshkrime, dokumente, apo arkiva personale të individëve të burgosur apo internuar dhe janë përzgjedhur nga dëshmitë gojore të mbijetuarve. Shprehjet, dikur të ndaluara, u projektuan në formate të mëdha, në fasadat kryesore të qyteteve, deri në agim duke riafirmuar vlerat europiane, që ishin dhe vizioni i rrëfimtareve.
- Përmes artit, projekti synon t’i njohë dhe t’i ftojë për reflektim të rinjtë, komunitetet dhe publikun e gjerë me trashëgiminë e së shkuarës komuniste.
- Format e komunikimit me publikun e gjerë brenda dhe jashtë vendit u shumëfishuan përmes faqes elektronike “Edhe muret kanë veshë - <http://evenwallshavee-ars.org/>” e cila, mes të tjerash mundëson pasurimin në vijueshmëri të databazës me dëshmi që i shtohen arkivit të Autoritetit.
- Dëshmitë gojore janë filmuar në një dokumentar, në mënyrë që njerëzit ta ndjekin rrugëtimin e këtij produkti artistik, t’i shohin fytyrat dhe t’i dëgjojnë historitë e shqiptarëve që qëndruan me dinjitet gjatë periudhës të regjimit totalitar.
- Vendosja e dialogut me të rinjtë, studentët dhe stafin akademik për të folur mbi kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri është arritur përmes ditëve të hapura në tre universitete të vendit, në Shkodër, Durrës dhe Korçë. Rreth 300 studentë, pedagogë, të mbijetuar të regjimit komunist dhe familjet e tyre ishin të pranishëm gjatë ditëve të hapura.



Projeksioni në Tepelenë



Projeksioni në Tiranë



Projeksioni në Shkodër

Puna në të ardhmen

- Përdorimi i artit dhe mjeteve të larmishme të komunikimit, përfshirë rrjetet sociale, për të realizuar informimin dhe ndërgjegjësimin edukativ si edhe për të vijuar me dialogun me të rinjtë, grupet e interesit, median dhe publikun e gjerë për transparencën historike.
- Zhvillimi i orëve të hapura mbi këtë tematikë në universitetet shqiptare, publike dhe private.
- Përfshirja në programet mësimore të niveleve të ndryshme të arsimit parauniversitar, një ose disa orë mësimore, me tematikë nga e shkuara komuniste.